



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT "XHAFER SADIKU"

NIPT L22320010S; Adresa: Rr. "Halil Patrona", Tiranë; xhaferdsadiku@gmail.com

N r. 158 Prot
r. 99 Regjistri

Tiranë, më 31/10 / 2017

URDHER

(Për venie sekuestro konservative)

Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Për dijëni: Albanian General Electricity me NUIS/NIPT L41706021V
Shoqërisë tregtare "AGE TUJAN" shpk. me NUIS L61320003O.

Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurisë Ujore sh.p.k.

Unë Xhafer Sadiku, përmbarues gjyqësor privat, me Çertifikatë nr. 132, pasi studiova dokumentacionin ligjor të administruar me kërkesën e kreditorit Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurisë Ujore sh.p.k.,

V R E J T A:

Se më 16 dhjetor 2016 kreditori kanë bërë kërkesë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, Faturë Tatimore Shitje me nr. 30, Nr. Serie 06183231, datë 02.05.2016 të lëshuar nga Shoqëria tregtare Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurisë Ujore sh.p.k. Ky titull ekzekutiv u përket palëve:

- Kreditor : Shoqëria tregtare Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurisë Ujore sh.p.k.
- Debitor : Shoqëria tregtare "AGE TUJAN" shpk. me NUIS L61320003O.
- Objekti : Pagim shume.

Detyrimi që përmban Fatura Tatimore është në vlerën totale 12000 (dymbëdhjetë mijë Euro) Për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 7745 Akti, datë 05.12.2016 ka vendosur lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit për Faturën Tatimore të Shitjes nr. 30, Nr. Serie 06183231, datë 02.05.2016 të lëshuar nga Shoqëria tregtare Qendra e Vlerësimit dhe Zhvillimit të Pasurisë Ujore sh.p.k. kundrejt shoqërisë tregtare "AGE TUJAN" shpk.

Debitori duhet të paguajë edhe 4,8 për qind e shumës si tarifë përmbarimore, në shumën 576 Euro, si dhe 20% TVSH = 114 Euro; bazuar në Udhëzimin nr. 1240/5, dt.15.09.2009, të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave.

Debitori duhet të paguajë edhe shumën 227.100 lekë të barabartë me 1.701 Euro dhe 50000 lekë faturën tatimore për ekspertin.

Gjithsej debitori duhet të paguajë shumën 14.391 (katërmëdhjetëmijë e treqind e nëntëdhjetë e një) Euro dhe 50000 lekë(374,5 EURO).

Duke qenë se debitori nuk e shleu detyrimin në mënyrë vullnetare, ekzekutimi duhet të bëhet në

mënyrë të detyruruar. Për këtë duhet të vihet sekuestro konservative mbi kuotat e kapitalit qe shoqëria **Albanian General Electricity me NUIS/NIPT L41706021V** ka tek **AGE TUJAN me NUIS L61320003O**, ne shumen **14.765** (katërbëdhjetëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro plus interesat deri ne shlyerjen e detyrimit, si edhe të mos kryje shitjen e ketyre kuotave.

Për sa më sipër,
mbështetur në nenet 519 e 527 të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

- Venien e sekuestros konservative mbi kuotat e kapitalit qe shoqëria Albanian General Electricity me NUIS/NIPT L41706021V ka tek shoqëria AGE TUJAN me NUIS L61320003O, ne shumen **14.765** (katërbëdhjetëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro, plus interesat deri ne shlyerjen e detyrimit, si edhe të mos kryje shitjen e ketyre kuotave.

- Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor palët mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda pesë ditëve nga marrja dijani.

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT



XHAFER SADIKU

